



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:209070

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05383353

C.nr.1962/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.M. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson avokatura “Klinaku &” nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 5,376.17 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 20.09.2018 deri më datë 30.06.2022 apo për 45 muaj e 11 ditë pune (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro dhe për 11 ditë shumën prej 20.29 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 2,510.29 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 20.09.2021 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 5,376.17 euro, përkatësisht shuma prej 2,865.88 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja L.M. nga Prizreni, përmes të autorizuarës së saj, avokatura “Klinaku & ...” nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 5,376.17 euro.

Në padi, paditësja ka theksuar se është e punësuar si mësimdhënëse pranë SHFMU “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në fshatin Mazrek, Komuna e Prizrenit, me titull Bachelor i Programit

Fillor. Pasi që paditësja është e kualifikuar me nivelin Fakultet i Edukimit, asaj i është e garantuar pagesa shtesë prej 27% në pagën bazë dhe 10% të pagës bazë, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Tutje ka shtuar se paditësja realizon pagën bazë në shumën prej 421.00 euro, ndërsa pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e lartcekur, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura në kompensimin e këtij detyrimi ndaj paditëses, nga data 18.04.2017 deri më 22.01.2021, përkatësisht nga data 22.01.2021 e në vazhdim, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor deri në pagesën definitive dhe në kompensimin e shpenzimeve të procedurës.

Me parashtrësën e datës 28.07.2022, i autorizuari i paditëses ka kërkuar që paditëses t'i njihet e drejta e kompensimit të pagës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, në shumë prej 113.67 euro për çdo muaj në pagën bazë prej 421.00 euro, nga data 18.04.2017 deri më 31.12.2020 dhe për çdo muaj nga 42.10 euro në pagën bazë prej 421.00 euro, nga data 01.01.2021 deri më 30.06.2022, në shumën e përgjithshme prej 5,376.17 euro.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtare e kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësja nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditëses. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, precizimit të datës 28.07.2022, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja L.M. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë SHFMU “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” në fshatin Mazrek, Komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes kontratës së punës nr. 74/18 e datës 25.05.2018, gjykata vërtetoi faktin se kualifikimi i paditëses është Fakultet- Bachelor i Programit Fillor. Po ashtu, një fakt i tillë vërtetohet edhe nga diploma nr. 1135 e datës 21.12.2017, lëshuar në emër të paditëses.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit Fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj, meqë këto dokumente, përkatësisht kontrata e punës, diploma dhe lista e pagave janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditëses ia ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro.

Mirëpo, duke marrë parasysh që kërkesa e paditëses është parashtruar lidhur me pagën bazë në lartësi prej 421.00 euro, gjykata vendosi që paditëses i takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 421.00 euro apo në shumë prej 55.35 euro. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro, për periudhën kohore prej datës 20.09.2018 deri më datë 30.06.2022 apo për 45 muaj e 11 ditë pune, shumën e përgjithshme prej 2,510.29 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 55.35 euro, duke e shumëzuar për 45

muaj ($45 \times 55.35 = 2,490.00$ euro) dhe kjo diferencë duke e llogaritur për 11 ditë ($11 \times 1,845 = 20.29$ euro) apo në mënyrë të përmbledhur ($2,490.00 + 20.29 = 2,510.29$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 20.09.2021, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 20.09.2021, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 19.09.2018.

Më saktësisht, gjykata vlerëson se përkundër faktit se paditëses e drejta për kompensimin e pagës shtesë mbi bazën e kualifikimit i është bërë e arritshme në fund të muajit- fillim të muajit, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, në mënyrë specifike dhe konkrete përcaktohet se kërkesat e tilla ndërpriten me rastin e parashtrimit të kërkesës- padisë, sipas nenit 369 të LMD-së. Kështu, paditësja ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data 20.09.2018 deri më datë 30.06.2022.

Po ashtu, gjykata vlerëson se kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, në pagën bazë prej 421.00 euro, përkatësisht në diferencën prej 58.32 euro, për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri më 31.12.2020, është e pabazuar. Në të vërtetë, nga provat e theksuara më lartë, përkatësisht nga kontrata e punës nr. 74/18 e datës 25.05.2018 dhe lista e pagave, rezulton se e paditura, paditëses ia ka kompensuar diferencën në shumë prej 58.32 euro, për periudhën e theksuar më lartë. Gjithashtu, gjykata gjen se kërkesa e paditëses për kompensimin e kualifikimit apo licencimit nga data 01.01.2021 deri më 30.06.2022, në nivel prej 10% në pagën bazë prej 421.00 euro apo 42.10 euro për çdo muaj, është e pabazuar. Kjo për faktin se një kërkesë e tillë nuk gjen mbështetje në dispozitat e lartcekura të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, kërkesa e paditëses e cila është parashkruar dhe e pabazuar në prova dhe dispozita ligjore, rezulton të jetë në shumën prej 2,865.88 euro, bazuar në shumën e kërkuar nga pala paditëse dhe pjesës aprovuese sipas arsyeve të theksuara më lartë. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses

është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452 par. 2 të LPK-së, ashtu që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale. Kështu, gjykata me rastin e vendosjes në mënyrë të tillë ka marrë parasysh suksesin e palës paditëse në procedurë, përkatësisht lartësinë e kërkesëpadisë së aprovuar në raport me lartësinë e kërkesëpadisë së kërkuar nga pala paditëse.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1962/2021, datë 27.02.2024

Gjyqtari,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.